




Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Zyra Kombëtare e Auditimit
Nacionalna Kancelarija Revizije
National Audit Office

RAPORTI I AUDITIMIT PËR PASQYRAT FINANCIARE VJETORE TË KOMUNËS SË GLLOGOCIT PËR VITIN 2023

Prishtinë, qershor 2024

PËRMBAJTJA E RAPORTIT

- 1 Opinioni i Auditimit
- 2 Gjetjet dhe rekomandimet
- 3 Informacion i përmbledhur për planifikimin dhe realizimin e buxhetit
- 4 Progresi në zbatimin e rekomandimeve

Shtojca I: Letër konfirmimi

Shtojca II: Shpjegim lidhur me llojet e të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZKA dhe pjesëve të tjera të Raportit të Auditimit

1 Opinioni i Auditimit

Ne kemi përfunduar auditimin e pasqyrave financiare të Komunës së Glllogocit për vitin e përfunduar më 31 Dhjetor 2023, në përputhje me Ligjin për Auditorin e Përgjithshëm dhe Zyrën Kombëtare të Auditimit të Republikës së Kosovës dhe Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Auditimi është kryer për të na mundësuar të shprehim opinionin për pasqyrat financiare dhe konkluzionin për pajtueshmërinë me autoritetet.¹

Opinion i pamodifikuar për pasqyrat financiare vjetore

Ne i kemi audituar pasqyrat financiare vjetore të Komunës së Glllogocit (GLL), të cilat përmbajnë pasqyrën e pranimeve dhe pagesave në para të gatshme, raportin e ekzekutimit të buxhetit si dhe shënimet shpjeguese për pasqyrat financiare, përfshirë përmbledhjen e politikave të rëndësishme të kontabilitetit dhe raportet tjera², për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2023.

Sipas opinionit tonë, Pasqyrat Financiare Vjetore të Komunës së Glllogocit, prezantojnë një pamje të drejtë dhe të vërtetë në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit për Sektorin Publik, sipas kontabilitetit të bazuar në para të gatshme.

Baza për opinion

Auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Sipas këtyre standardeve, përgjegjësitë tona janë përshkruar më poshtë tek pjesa e raportit 'Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Financiare'. Në përputhje me ONISA-P-10, SNISA 130, Kodin e Etikës së ZKA-së, si dhe kërkesat tjera relevante për auditimin e PFV-ve të organizatave buxhetore, ZKA është e pavarur nga subjekti i auditimit. Besojmë se dëshmitë e auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të duhura për sigurimin e bazës për opinion.

Konkluzion për pajtueshmërinë

Ne kemi audituar nëse proceset dhe transaksionet përcjellëse janë në pajtueshmëri me kriteret e përcaktuara të auditimit që burojnë nga legjislacioni i zbatueshëm për subjektin e audituar në kontekstin e përdorimit të burimeve financiare.

Sipas mendimit tonë, përveç ndikimeve të çështjes/ve të përshkruara në seksionin Baza për Konkluzion të pajtueshmërisë, transaksionet e kryera në procesin e ekzekutimit të buxhetit Komunës së Glllogocit kanë qenë, në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me kriteret e përcaktuara të auditimit që burojnë nga legjislacioni i zbatueshëm për subjektin e audituar në kontekstin e përdorimit të burimeve financiare.

Baza për konkluzion

- A1 Në një rast paramasa dhe parallogaria nuk ishte përgatitur sipas kërkesave të rregullores për prokurim publik.
- B1 Mungesa e projekteve ekzekutuese.

Më gjerësisht shih nënkapitullin 2.1 Çështjet që ndikojnë në konkluzionin e pajtueshmërisë

Auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Sipas këtyre standardeve, përgjegjësitë tona janë përshkruar më poshtë tek pjesa 'Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Financiare'. Në përputhje me ONISA-P-10, SNISA 130, Kodin e Etikës së ZKA-së, si dhe kërkesat e tjera relevante për auditimin e PFV-ve të organizatave buxhetore, ZKA-ja është e pavarur nga subjekti i auditimit. Besojmë se dëshmitë e auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të duhura për sigurimin e bazës për konkluzion.

Përgjegjësitë e Menaxhmentit dhe të organeve drejtuese/qeverisëse për pasqyrat financiare vjetore

Kryetari i Komunës është përgjegjës për përgatitjen dhe prezantimin e drejtë të Pasqyrave Financiare sipas Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit në Sektorin Publik - Raportimi Financiar bazuar në Kontabilitetin e Parasë së Gatshme. Po ashtu, Kryetari i Komunës është përgjegjës edhe për vendosjen e kontroleve të brendshme, të cilat i përcakton si të nevojshme për të mundësuar përgatitjen e Pasqyrave Financiare, pa keq deklarime materiale të shkaktuara, qoftë nga mashtrimi apo gabimi. Kjo përfshinë përmbushjen e kërkesave që burojnë nga Ligji nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë dhe Rregullorja nr. 01/2017 për Raportim Vjetor Financiar nga Organizata Buxhetore.

Kryetari i Komunës është përgjegjës për të siguruar mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të Komunës së Glllogocit.

Përgjegjësia e Menaxhmentit për Pajtueshmërinë

Menaxhmenti i Komunës së Glllogocit është gjithashtu përgjegjës për përdorimin e burimeve financiare të Komunës së Glllogocit në përputhje me Ligjin për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësinë dhe të gjitha rregullat dhe rregulloret e tjera të zbatueshme.³

Përgjegjësia e Auditorit të Përgjithshëm për auditimin e PFV-ve

Objektivat tona janë të ofrojmë siguri të arsyeshme nëse pasqyrat financiare si tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit dhe të hartojmë një raport të auditimit që përfshin opinionin tonë. Siguria e arsyeshme është siguri e nivelit të lartë, por nuk është një garanci se një auditim i kryer në përputhje me SNISA-t do të zbulojë çdo keq-deklarim material që mund të ekzistojë. Keq-deklarimet mund të vijnë nga mashtrimi ose gabimi dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose si tërësi, në mënyrë të arsyeshme pritet të ndikojnë në vendimet ekonomike të përdoruesve të marra në bazë të këtyre pasqyrave financiare.

Objektivi ynë është gjithashtu të shprehim një konkluzion të auditimit për pajtueshmërinë e autoriteteve përkatëse të Komunës së Gillogocit me kriteret e përcaktuara të auditimit që burojnë nga legjislacioni i zbatueshëm në kontekstin e përdorimit të burimeve financiare, lidhur me subjektin e audituar.

Si pjesë e auditimit në përputhje me Ligjin për ZKA dhe SNISA-të, ne ushtrojmë gjykim dhe skepticizëm profesional gjatë gjithë auditimit. Ne gjithashtu:

- Identifikojmë dhe vlerësojmë rreziqet e keq-deklarimit material të pasqyrave financiare, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit, hartojmë dhe kryejmë procedurat e auditimit që i përgjigjen atyre rreziqeve, dhe marrim dëshmi të auditimit që janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të siguruar bazën për opinionin. Rreziku i mos zbulimit të një keq-deklarimi material që rezulton nga mashtrimi është më i lartë sesa për atë që rezulton nga gabimi, pasi mashtrimi mund të përfshijë manipulim, falsifikim, lëshime të qëllimshme, keq përfaqësime ose anashkalim të kontroleve të brendshme.
- Identifikojmë dhe vlerësojmë rreziqet e mos-pajtueshmërisë me autoritetet, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit, hartojmë dhe kryejmë procedurat e auditimit që janë përgjegjëse ndaj atyre rreziqeve, dhe marrim dëshmi të auditimit që janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të siguruar bazën për konkluzionin tonë për pajtueshmërinë me autoritetet. Rreziku i mos zbulimit të një rasti të mos pajtueshmërisë me autoritetet që vjen nga mashtrimi është më i lartë sesa për atë që rezulton nga gabimi, pasi mashtrimi mund të përfshijë manipulim, falsifikim, lëshime të qëllimshme, keq përfaqësime ose anashkalim të kontrollit të brendshëm.
- Sigurohemi ta kuptojmë kontrollin e brendshëm relevant për auditimin, për t'i hartuar procedurat e auditimit që janë të përshtatshme, por jo me qëllim të shprehjes së një opinionimi mbi efektivitetin e kontrollit të brendshëm të Komunës së Gillogocit.
- Vlerësojmë përshtatshmërinë e politikave të kontabilitetit të përdorura dhe arsyeshmërinë e vlerësimeve të kontabilitetit dhe shpalosjet e ndërlidhura të bëra nga menaxhmenti.
- Vlerësojmë prezantimin e përgjithshëm, strukturën dhe përmbajtjen e pasqyrave financiare, përfshirë shpalosjet, për t'u siguruar se pasqyrat financiare paraqesin transaksionet dhe ngjarjet themelore në mënyrë të drejtë dhe të saktë.

Ndër të tjera, ne komunikojmë me menaxhmentin dhe ata që janë përgjegjës për qeverisjen edhe në lidhje me fushëveprimin dhe kohën e planifikuar të auditimit dhe gjetjet e rëndësishme të auditimit, përfshirë ndonjë mangësi domethënëse në kontrollin e brendshëm që ne e identifikojmë gjatë auditimit.

Nga çështjet e komunikuar me menaxhmentin, ne përcaktojmë ato çështje që ishin më të rëndësishme në auditimin e Pasqyrave Financiare të periudhës aktuale dhe që cilësohen si çështje kyçe të auditimit. Raporti i auditimit publikohet në ueb faqen e ZKA-së, me përjashtim të informacioneve që klasifikohen si senzitive apo për shkak të ndalesave të tjera ligjore e administrative, në pajtim me legjislacionin në fuqi.

2 Gjetjet dhe rekomandimet⁴

Gjatë auditimit, ne kemi vërejtur fusha ku nevojiten përmirësime të dukshme, rreth menaxhimit financiar dhe Kontrollit. Dobësi evidente janë vërejtur në fusha të rëndësishme financiare si: Keq klasifikimi i shpenzimeve si rezultat i pagesave me vendime gjyqësore për zbatim të kontratës kolektive, mangësi në menaxhimin e të hyrave, mangësi në zhvillimin e aktiviteteve të prokurimit, dhe menaxhim të kontratave të cilat janë paraqitur më poshtë për shqyrtimin tuaj në formë të gjetjeve dhe rekomandimeve. Gjetjet dhe rekomandimet kanë për qëllim të përmirësojnë informacionin financiar të paraqitur në pasqyrat financiare, duke përfshirë shpalosjet në formë të shënimeve shpjeguese dhe të përmirësojnë kontrollet e brendshme lidhur me raportimin financiar dhe pajtueshmërinë me autoritetet në lidhje me menaxhimin e fondeve të sektorit publik. Ne do t'i përcjellim (shqyrtojmë) këto rekomandime gjatë auditimit të vitit të ardhshëm.

Gjithashtu, duhet të theksojmë se për vitin 2023, Thesari kishte ekzekutuar përmes procedurave përmbartimore/gjyqësore shpenzime nga kategori ekonomike joadekuate në vlerë prej 181,315€, prej tyre shpenzime të interesit dhe përmbartimit ishin 58,011€, për obligimet që kanë dalë nga kontrata kolektive. Këto shpenzime kanë të bëjnë me pagesat që janë bërë për shujta për kontratën kolektive.

Ky raport ka rezultuar me pesë (5) rekomandime, prej tyre tri (3) janë rekomandime të reja dhe dy (2) të përsëritura.

Derisa për statusin e rekomandimeve të vitit paraprak dhe nivelin e zbatimit të tyre, shih kapitullin 4.

2.1 Çështjet që ndikojnë në konkluzionin e pajtueshmërisë

Çështja A1 - Mangësi në përgatitjen e paramases dhe parallogarisë

Gjetja Rregullorja Nr.001/2022 për prokurim publik, neni 19 përcakton që AK do të specifikojë në dosjen e tenderit të gjitha specifikimet teknike të cilat çdo tender duhet ti përmbush. Specifikimet teknike do të përshkruajnë dhe përkufizojnë, në mënyrë jo-diskriminuese, karakteristikat e obligueshme të objektit të kontratës, siç janë cilësia, performanca, kërkesat e dizajnit, dimensionet, siguria, sigurimi i cilësisë, terminologjia, simbolet, testimi dhe metodat e testimit, paketimi, shënimi dhe etiketimi. Specifikimet duhet të jenë të qarta, sakta dhe precize dhe të përkufizohen në mënyrë që mos të krijojnë paqartësi rreth natyrës së mallrave, punëve ose shërbimeve të kërkuara.

Tek aktiviteti i prokurimit : Instalimi i nxemjeve nëpër Qendrat e mjeksisë familjare dhe ambulantat e mjeksisë familjare, kontrata e nënshkruar me datë 26.05.2023, në vlerë 69,737€, kemi vërejtur se kishte mangësi sa i përket përgatitjes së paramases dhe parallogarisë.

Në dy pozicione nuk ishin definuar qartë paramasa dhe parallogaria: Tek paramasa në pozicionin 1.1 ishte paraparë "furnizimi dhe vendosja e klimave për ngrohje dhe ftohje përfshirë funksionalizimin e tyre. Specifikimet teknike përfshinin furnizimin me 8 copë klima 12BTU, 9 copë klima 18BTU dhe 9 copë klima 24 BTU". Pra është dashtur të ndahen në pozicione të ndryshme. Po ashtu tek pozicioni 1.3 ku përfshihej "furnizimi dhe vendosja e klimave në vendin e caktuar. Ky pozicion është dashur të jetë më i detajuar sa i përket specifikimeve teknike, sepse kjo shkakton paqartësi tek ofertuesit.

Kjo kishte ndodhur për shkak të funksionimit jo të mirë të kontrolleve të brendshme.

Ndikimi Specifikimet e pa qarta krijojnë paqartësi rreth natyrës së mallrave, punëve ose shërbimeve të kërkuara, njëherësh kjo shkakton vështirësi në zbatim të kontratës.

Rekomandimi A1 Kryetari duhet të ndërmarrë masa për të siguruar funksionimin e plotë të kontrolleve që kanë të bëjnë me përgatitjen e paramases dhe parallogarisë.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

Çështja B1 - Mungesa e projekteve ekzekutuese

Gjetja Rregullorja Nr001/2022 për prokurim publik, neni 19.17 kërkon që "Specifikat teknike për kontratën e punës, duhet të përfshijnë një projekt ekzekutues si pjesë substanciale të veten". "Autoriteti kontraktues është përgjegjës për hartimin e projektit ekzekutues dhe i cili në mënyrë mandatore duhet ti bashkëngjitet specifikave teknike të cilat janë pjesë e dosjes së tenderit". Asnjë Autoriteti Kontraktues nuk i lejohet që të lëshojë dokumentacionin e tenderit pa bashkëngjitur përshkrimin e hollësishëm të projektit.

Nga mostrat e testurara kemi vërejtur se në katër (4) raste për projekte kapitale, komuna nuk kishte hartuar projektin ekzekutues, por i kishte zhvilluar procedurat e prokurimit duke përgatitur vetëm paramasën dhe parallogarinë:

1) Projekti "Ndërtimi, zgjerimi dhe rikonstruimi i rrugëve të asfaltuara në Drenas" - Projekt trevjeçar. 2) Projekti "Infrastruktura në Komoran I, II, III, IV". 3) Projekti "Asfaltimi i rrugëve në fshatin Verbovc, Shtutic, Polluzhë dhe asfaltimi i rrugës në fshatin Tërstenik I, II dhe Gllobar" - Projekt dyvjeçar. 4) Projekti "Ndërtimi i parkingjeve dhe pllatojeve: SH.Galica, Gani Sylë, 7 Marsi, XH.Lladrovci, H Prishtina dhe SH.Polluzh".

Kjo kishte ndodhur për shkak të funksionimit jo të mirë të kontrolleve në procesin e inicimit të aktivitetit të prokurimit.

Ndikimi

Mungesa e projekteve ekzekutuese dhe inicimi i procedurave për projekte kapitale vetëm me paramasë dhe parallogari, rritë rrezikun që gjatë procesit të ekzekutimit të projekteve të paraqiten pengesa të ndryshme si në aspektin profesional, ashtu edhe në vonesat e punimeve apo edhe në rritjen e kostove të projekteve.

Rekomandimi B1

Kryetari duhet të sigurojë se për të gjitha aktivitetet e prokurimit që kanë të bëjnë me punë, të mos iniciohen procedurat pa u siguruar specifika të qarta sipas projektit ekzekutues, të cilat do të ndikonin në eliminimin e vonesave dhe të kostove shtesë.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

2.2 Çështjet tjera të menaxhimit financiar dhe të pajtueshmërisë

2.2.1 Të hyrat

Të hyrat e realizuara nga komuna në vitin 2023 në total ishin 1,982,661€. Ato kanë të bëjnë me të hyrat nga tatimi në pronë, të hyrat nga lejet e ndërtimit, taksat administrative, të hyrat nga veprimtaritë biznesore, të hyrat nga qiraja etj. Përveç të hyrave të realizuara nga komuna të cilat janë paraqitur në tabelën e mëposhtme, komuna ka pranuar edhe të hyra indirekte që janë realizuar nga niveli qendror (gjjobat e gjykatave, gjjobat pyjore dhe dënimet e trafikut) në vlerë totale prej 804,080€.

Çështja A2 - Mangësi në databazën e tatimit në pronë

Gjetja Ligji nr. 06/L-005 për Tatimin në Pronën e Paluajtshme, neni 11 pika 1 definon: "Zbritja për vendbanimin parësor- Personi fizik, i cili vendos deri më 30 nëntor të vitit, para vitit tatimor se njësia e objektit shërben si vendbanim parësor dhe e deklaron këtë në komunë apo gjatë fazës së inspektimit, i lejohet zbritja prej 15,000€ nga vlera e vlerësuar e njësies së objektit. Po ashtu, Ministria e Financave përkatësisht Departamenti i Tatimit në Pronë ka njoftuar komunat për vendimin e marr për regjistrimin e numrit personal në rastin e zbatimit të nenit 11 të Ligjit nr. 06/L-005, kjo me qëllim të shmangies së duplikimeve/apo parregullsive dhe sigurimin e zbatimit efektiv të këtij neni.

Nga analiza e data bazës për tatimin në pronë të siguruar nga komuna, kemi vërejtur se 122 personave iu ishte bërë zbritja e tatimit në pronë pa numër personal.

Kjo ka ndodhur për shkak të funksionimit jo të mirë të kontrolleve të brendshme në departamentin e tatimit në pronë.

Ndikimi Vlerësimi i njësive rezidenciale me zbritje pa numër personal mund të rezultojë me kalkulum të parregullt të zbritjes apo shmangie nga tatimi në pronë, ku për pasojë komuna pranon më pak të hyra nga kjo kategori. Për më tepër, regjistrimi i numrave personal rrit efikasitetin, garanton informata më të sakta dhe të besueshme në regjistrin e tatimit në pronë.

Rekomandimi A2 Kryetari duhet të marrë veprime shtesë për të siguruar se janë bërë korrigjimet e nevojshme në data bazën e tatimit në pronë, në mënyrë që zbritja për vendbanim parësor të bëhet vetëm për personat fizik të cilët janë të regjistruar me numër personal dhe kanë deklaruar në komunë se objekti shërben si vendbanim parësor.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

2.2.2 Investimet kapitale

Buxheti final për investime kapitale ishte 9,426,650€, prej tyre në 2023 ishin shpenzuar 7,493,242€. Ato kanë të bëjnë kryesisht me ndërtimin dhe rregullim të infrastrukturës rrugore, ujësjellësit dhe kanalizimeve, ndërtim të objekteve sportive/kulturo, parqeve, blerje të pajisjeve si dhe përmirësime të ndryshme të kapitalit.

Çështja A3 - Monitorimi i menaxhimit të kontratave jo përmes E-prokurimit

Gjetja Paragrafi 70.24.f. i Rregullores nr.001/2022 për Prokurimin Publik parasheh se “Menaxheri i kontratës të sigurojë që të gjitha regjistrat e menaxhimit të kontratës të përgatiten, mbahen dhe arkivohen në modulën për menaxhim të kontratës në sistem të prokurimit elektronik”.

Menaxherët e kontratave/projekteve nuk kanë mbajtur dhe arkivuar menaxhimin e kontratave dhe vlerësimin e performancës së kontraktuesve përmes sistemit elektronik të prokurimit publik.

Kjo ka ndodhur për shkak të funksionimit jo të mirë të kontrolleve të brendshme.

Ndikimi Mos mbajtja dhe arkivimi i kontratave përmes sistemit të prokurimit publik mund të ndikoj në një menaxhim jo të mirëfilltë të kontratave si dhe nuk ofron mundësi të mjaftueshme që menaxhmenti të merr informata me kohë në lidhje me progresin dhe performancën e kontratave.

Rekomandimi A3 Kryetari duhet të kërkojë nga të gjithë menaxherët e projekteve për tu siguruar që menaxhimi i kontratave do të mbahet dhe arkivohet nga sistemi elektronik i prokurimit publik.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

Çështja B2 - Klasifikimi jo adekuat i shpenzimeve në kategorinë ekonomike

Gjetja Rregulla financiare nr. 01/2013 për shpenzimet publike, neni 18, pika 3 përcakton se shpenzimet duhet të kenë kodet adekuate, të përcaktuara me Udhëzimin Administrativ për planin kontabël. Po ashtu, neni 11 i UA 19/2009 për planin kontabël, kërkon nga ZKA dhe ZKF që të sigurojnë që të gjitha transaksionet janë regjistruar në SIMFK sipas strukturës së planit kontabël dhe klasifikimeve të përcaktuara me këtë UA.

Përmes pagesave direkte nga Thesari bazuar në vendime gjyqësore gjatë vitit 2023 transaksione në vlerë 181,315€ ishin realizuar për pagat jubilarë dhe shujta nga kategoria ekonomike joadekuate. Prej tyre nga investimet kapitale ishin realizuar 98,751€, nga mallrat dhe shërbimet 58,248€, si dhe nga subvencionet 24,316€

Pagesat për paga jubilarë dhe shujta kanë ndodhur si rezultat i kontratës kolektive, shpenzimet e të cilave nuk janë planifikuar në buxhet. Megjithatë, këto pagesa janë ekzekutuar nga thesari.

Ndikimi Planifikimi dhe realizimi i shpenzimeve nga kategoritë ekonomike jo adekuate, ndikon në mbivlerësimin/nënvlerësimin e kategorive përkatëse të

shpenzimeve dhe të pasurive. Si rrjedhojë ndikon në prezantim jo të drejtë të shpenzimeve në PVF.

Rekomandimi B2

Kryetari duhet të sigurojë që janë ndërmarrë të gjitha veprimet që shpenzimet të planifikohen në ndarjet adekuate të buxhetit (apo të ridestinoen mjetet kur është e nevojshme dhe e mundshme) dhe që pagesa e regjistrimi i shpenzimeve bëhet sipas kodeve ekonomike adekuate.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

3 Informacion i përmbledhur për planifikimin dhe realizimin e buxhetit

Në këtë kapitull kemi prezantuar një informacion të përmbledhur për burimet e fondeve buxhetore, shpenzimin e fondeve dhe të hyrave të mbledhura, sipas kategorive ekonomike. Kjo është ilustruar përmes tabelave dhe grafikëve të mëposhtëm:

Tabela 1. Shpenzimet sipas burimeve të fondeve buxhetore (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti final ⁵	2023 Shpenzimet	2022 Shpenzimet	2021 Shpenzimet
Burimet e fondeve	18,156,892	24,001,710	21,603,045	17,510,741	15,432,138
Grante Qeveritare - Buxheti	16,799,424	18,671,110	18,024,090	14,981,037	13,060,000
Financimi përmes huamarrjes	0	0	0	127,905	71,560
Të bartura nga viti i kaluar	0	1,624,608	1,597,939	957,593	842,370
Të hyrat vetanake	1,357,468	2,184,378	1,580,064	939,348	926,588
Donacionet vendore	0	2,213	0	0	11,008
Donacionet e jashtme	0	1,519,401	400,953	504,858	520,613

Buxheti përfundimtar është më i lartë se buxheti fillestar për 5,844,818€. Rritja ishte nga gandi qeveritar 1,871,686€, të hyrave të bartura nga viti i kaluar me vlerë 1,624,608€, të hyrat vetanake 826,910€, si dhe nga donacionet 1,521,614€.

Në vitin 2023 Komuna e Glllogocit ka shpenzuar 90% të buxhetit përfundimtar ose 21,603,045€, me një zvogëlim prej 5% krahasuar me vitin paraprak 2022 (95%).


Tabela 2. Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti final	2023 Shpenzimet	2022 Shpenzimet	2021 Shpenzimet
Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike	18,156,892	24,001,710	21,603,045	17,510,741	15,432,138
Pagat dhe mëditjet	9,038,054	10,909,740	10,909,740	9,671,999	8,914,997
Mallrat dhe shërbimet	2,335,494	2,718,217	2,426,270	2,143,765	1,411,089
Komunalitë	322,249	346,249	315,379	275,283	213,075
Subvencionet dhe transferet	420,000	473,854	458,415	413,004	380,103
Investimet Kapitale	5,914,095	9,426,650	7,493,242	5,006,690	4,512,873
Rezervat	127,000	127,000	0	0	0

Shpjegimet për ndryshimet në kategoritë e buxhetit janë dhënë më poshtë:

- Buxheti final për paga dhe mëditje në raport me buxhetin fillestar ishte rritur për 1,871,686€ kjo rritje vjen si rezultat i të hyrave të bartura nga viti i kaluar, dhe Vendimet e Qeverisë së Kosovës për realizimin e ligjit të ri të pagave. Realizimi i buxhetit në këtë kategori ishte 100%.
- Buxheti final për mallra dhe shërbime gjithashtu ishte rritur për 382,723€ në krahasim me buxhetin fillestar, kjo rritje vjen si rezultat i të hyrave vetanake të bartura nga viti i kaluar. Ndërsa ekzekutimi i buxhetit është relativisht i lartë në këtë fushë me rreth 89%.
- Buxheti final për shpenzime komunale ishte rritur për 24,000€ në krahasim me buxhetin fillestar, kjo rritje vjen si rezultat i të hyrave vetanake të bartura nga viti i kaluar. Ndërsa ekzekutimi i buxhetit është relativisht i lartë në këtë fushë me rreth 91%.
- Buxheti final për Subvencione dhe transfere ishte rritur për 53,854€ në krahasim me buxhetin fillestar, kjo rritje ishte rezultat i të hyrave vetanake të bartura nga viti i kaluar. Realizimi në këtë kategori ishte rreth 97% e buxhetit final.
- Buxheti final në krahasim me buxhetin fillestar për investime kapitale ishte rritur për 3,512,555€. Kjo rritje ishte rezultat i të hyrave të bartura nga viti i kaluar dhe donacioneve. Buxheti në këtë kategori është shpenzuar rreth 79.5%.

Grafiku 1. Shpenzimet sipas kategorive ekonomike për vitin 2023



Të hyrat e realizuara nga komuna në vitin 2023 në total ishin 1,982,661€. Ato kanë të bëjnë me të hyrat nga tatimi në pronë, të hyrat nga lejet e ndërtimit, taksat administrative, të hyrat nga veprimtaritë biznesore, të hyrat nga qiraja etj. Përveç të hyrave të realizuara nga komuna të cilat janë paraqitur në tabelën e mëposhtme, komuna ka pranuar edhe të hyra indirekte që janë realizuar nga niveli qendror (gjobat e gjykatave, gjobat pyjore dhe dënimet e trafikut) në vlerë totale prej 804,080€.

Tabela 3. Të hyrat (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti final	2023 Pranimet	2022 Pranimet	2021 Pranimet
Totali i të hyrave	1,357,468	1,357,468	1,982,661	1,509,673	1,167,354
Të hyrat tatimore	748,782	748,782	927,166	674,100	716,423
Të hyrat jo tatimore	608,686	608,686	1,051,559	835,572	450,932
Të hyrat tjera	0	0	3,936		

4 Progresi në zbatimin e rekomandimeve

Raporti i auditimit për PVF-të të vitit 2022, ka rezultuar në nëntë (9) rekomandime. Komuna kishte përgatitur Planin e Veprimit ku paraqitet mënyra se si do t'i zbatoj rekomandimet e dhëna. Raporti i auditimit i vitit 2022 ishte diskutuar në Asamblenë Komunale. Deri në fund të auditimit tonë për vitin 2023, shtatë (7) rekomandime janë zbatuar, ndërsa dy (2) rekomandime nuk janë zbatuar ende, siç është paraqitur në Grafikon 2, më poshtë. Për një përshkrim më të plotë të rekomandimeve dhe mënyrën se si janë trajtuar ato, shihni në Tabelën 4 (ose Tabelën e rekomandimeve).

Grafiku 2. Progresi në zbatimin e rekomandimeve të vitit paraprak




Tabela 4 Përmbledhja e rekomandimeve të vitit paraprak

Nr	Fusha e Auditimit	Rekomandimet e vitit 2022	Veprimet e ndërmarra	Statusi
1.	Baza për opinion	Kryetari duhet të siguroj se menaxherët e kontratave aplikojnë kontrolle efektive në procesin e menaxhimit të kontratave dhe të shpenzimit të parasë publike, për tu siguruar se raportet/situacionet për pagesë bëhen vetëm për punët e realizuara.	Nga mostrat e testuara nuk kemi vërejtur raste të tilla.	I zbatuar

2.	Baza për opinion	Kryetari duhet të sigurojë se taksa për ushtrimin e veprimtarisë biznesore ngarkohet ndaj bizneseve sipas rregullores komunale e cila tashmë ishte në proces të plotësimit ndryshimit si dhe të siguroj se përdoren softuer/sisteme efikase dhe efektive për menaxhimin e të hyrave nga taksat në biznese. Po ashtu, komuna duhet të bëjë marrëveshje me bizneset lidhur me mjetet financiare të paguara pa bazë në rregulloren komunale (mjetet financiare duhet t'u kthehen apo kartela e tyre financiare të vendoset në parapagim pasi që me rregulloren e re parashihet të përfshihen të gjitha kodet e veprimtarive sipas ARBK-së).	Komuna kishte ndërmarrë masa për ta adresuar këtë rekomandim.	I zbatuar
3.	Baza për konkluzion	Kryetari duhet të sigurojë se menaxherët e kontratave dhe zyra e prokurimit janë në njohuri me kërkesat ligjore për prokurimin publik (kjo mund të bëhet me anë të trajnimeve). Çdo ndryshim në kushtet e kontratës para ose gjatë periudhës së zbatimit, do të bëhet vetëm pas sigurimit se kjo është në pajtim të plotë me kërkesat ligjore në fuqi lidhur me ndryshimin e kontratave.	Nga mostrat e testuara nuk kemi vërejtur raste të tilla.	I zbatuar
4.	Baza për konkluzion	Kryetari duhet të sigurojë se për të gjitha aktivitetet e prokurimit që kanë të bëjnë me punë, të mos iniciohen procedurat pa u siguruar specifika të qarta sipas projektit ekzekutues, të cilat do të ndikonin në eliminimin e vonesave dhe të kostove shtesë.	Ky rekomandim nuk është zbatuar.	Nuk ka filluar zbatimi
5.	Baza për konkluzion	Kryetari duhet të sigurojë se për pozita të rregullta të punës angazhohet staf i rregullt përmes procedurave të rekrutimit dhe se procedurat e prokurimit për angazhimin e stafit për shërbime të veçanta aplikohen vetëm për pozita specifike dhe të veçanta të cilat nuk mund të mbulohen nga stafi i brendshëm i komunës.	Gjatë testimit të mostrave nuk kemi hasur në ndonjë pagesë të përsëritur të marrëveshjet e vecanta.	I zbatuar
6.	Të hyrat	Kryetari duhet të sigurojë kontrollë shtesë në sektorin e tatimit në pronë, në mënyrë që të dhënat në sistemin Protax të jenë të harmonizuara me rregulloren e tatimit në pronën e paluajtshme të komunës dhe me ligjin e tatimit në pronë.	Komuna kishte ndërmarrë masa për ta adresuar këtë rekomandim.	I zbatuar
7.	Investimet kapitale	Kryetari duhet të sigurojë që janë ndërmarrë të gjitha veprimet që shpenzimet të planifikohen në ndarjet adekuate të buxhetit (apo të ridestinohen mjetet kur është e nevojshme dhe e mundshme) dhe që pagesa e regjistrimi i shpenzimeve bëhet sipas kodeve ekonomike adekuate.	Ky rekomandim nuk ishte zbatuar në mungesë të buxhetit.	Nuk ka filluar zbatimi

8.	Pasuritë	Kryetari, duhet të sigurojë se të gjitha pasuritë e komunës janë identifikuar dhe regjistruar saktë në regjistrat përkatës të pasurive komunale. Po ashtu, duhet siguruar se procesi i inventarizimit të pasurive do të kryhet sipas kërkesave të Rregullores 02/2013 për menaxhimin e pasurive jo financiare në organizatat buxhetore, si dhe më pas, të bëhet krahasimi i rezultateve të inventarizimit me gjendjen kontabël të pasurive, duke i sqaruar të gjitha diferencat.	Komuna kishte ndërmarrë masa për ta adresuar këtë rekomandim.	I zbatuar
9.	Llogaritë e arkëtueshme	Kryetari, duhet të shqyrtojë të gjitha veprimet e mundshme përfshirë edhe ato ligjore, për të siguruar efikasitet më të lartë në arkëtimin e llogarive të arkëtueshme.	Komuna kishte ndërmarrë masa për ta adresuar këtë rekomandim.	I zbatuar

Vlora Spanca, Auditore e Përgjithshme



Agron Fetiu, Ndihmës Auditor i Përgjithshëm



Lavdim Maxhuni, Drejtor i Auditimit




Arian Haxha, Udhëheqës i ekipit



Mujë Gashi, Anëtar i ekipit



Shefkije Beka, Anëtare e ekipit



Shtojca I: Letër konfirmimi

KOMUNA GLOGOC
MUNICIPAL GLOGOC
DA Nr. 40301-29/14
20/06/2024



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo



Komuna e Drenasit
Zyra e Kryetarit

LETËR E KONFIRMIMIT

Për pajtueshmërinë me gjetjet e Auditorit të Përgjithshëm për vitin 2023 dhe për zbatimin e rekomandimeve

Për: Zyrën e Kombëtare të Auditimit

Të nderuar,

Përmes kësaj shkrese, konfirmoj se:

- kam pranuar draft raportin e Zyrës Kombëtare të Auditimit për auditimin e Pasqyrave Financiare të Komunës së Glogocit, për vitin 2023 (në tekstin e mëtejshëm "Raporti");
- pajtohem me gjetjet dhe rekomandimet dhe nuk kam ndonjë koment për përmbajtjen e Raportit; si dhe
- brenda 30 ditëve nga pranimi i Raportit final, do t'ju dorëzoj një plan të veprimit për zbatimin e rekomandimeve, i cili do të përfshijë afatet kohore dhe stafin përgjegjës për zbatimin e tyre.

Ramiz Lladrovci,
Kryetar i Komunës



Datë: 20/06/2024, Glogoc.

Shtojca II: Shpjegim lidhur me llojet e të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZKA dhe pjesëve të tjera të Raportit të Auditimit

Raporti i auditorit për pasqyrat financiare⁶ duhet të përmbajë një opinion për pasqyrat financiare, bazuar në përfundimet e nxjerra nga dëshmitë e marra gjatë auditimit. Kur auditimi kryhet për të vlerësuar gjithashtu përputhjen me legjislacionin dhe rregulloret e tjera, auditorët kanë një përgjegjësi shtesë për të raportuar për pajtueshmërinë me autoritetet⁷, duke rezultuar me konkluzion mbi pajtueshmërinë.

Për të arritur në përfundimin se një opinion mbi pasqyrat financiare është i modifikuar ose i pa modifikuar, një auditor duhet të sigurohet që rezultatet e auditimit përfshijnë, apo jo, keq-deklarim (e) material(e) ose të përhapur(a), apo të tillë(a) të mundshëm(me), të supozuar në rast kufizimi të fushëveprimit.

Keq-deklarimi është një ndryshim mes shumës së raportuar, klasifikimit, prezantimit ose zbulimit të një zëri të pasqyrës financiare dhe sasisë, klasifikimit, prezantimit ose zbulimit që kërkohet që zëri të jetë në përputhje me kornizën e raportimit financiar në fuqi. Keq-deklarimet mund të vijnë nga gabimi ose mashtrimi.

(shkëputur nga SNISA 200)

Forma e opinionit

Opinion i pa-modifikuar

Formulohet kur nuk janë zbuluar keq-deklarime ose mos-pajtueshmëri; kur janë zbuluar keq-deklarime ose mos-pajtueshmëri, qoftë një i vetëm apo një grumbull, por që nuk është i barabartë me ose nuk e tejkalon nivelin e materialitetit për pasqyrat financiare si tërësi; ose kur keq-deklarimi(et) dhe/ose mos-pajtueshmëria e zbuluar brenda një klase të caktuar transaksionesh nuk është e barabartë me ose e tejkalon nivelin e materialitetit më të ulët të vendosur për këtë klasë të transaksioneve. Formulohet gjithashtu nëse nuk ka kufizim të fushëveprimit ose kur kufizimi i fushëveprimit nuk mund të shpie në shmangie të keq-deklarimit(eve) material(e) dhe/ose mos-pajtueshmërisë(ve).

Kufizimi i fushëveprimit ndodh kur një auditor nuk është në gjendje të marrë dëshmi të mjaftueshme auditimi për të arritur në përfundimin se pasqyrat financiare në tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale.

Auditori duhet të japë **opinion të pa-modifikuar** nëse arrin në përfundimin se pasqyrat financiare janë përgatitur, në të gjitha aspektet materiale, në pajtim me kornizën e zbatueshme financiare.

Modifikimi i opinionit në raportin e auditorit

Auditori duhet të modifikojë opinionin në raportin e auditorit nëse konstatohet se, bazuar në dëshmitë e marra nga auditimi, pasqyrat financiare në tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale dhe/ose mos-pajtueshmëri, ose nuk është në gjendje të sigurojë prova të mjaftueshme të auditimit për të arritur në përfundimin se pasqyrat financiare në tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale dhe/ose mos-pajtueshmëri..

Opinionit i modifikuar mund të jetë:

- I kualifikuar,
- I kundërt, ose
- Mohim opinionit

Opinionit i kualifikuar

Formulohet kur janë zbuluar keq-deklarime dhe/ose mos-pajtueshmëri, qoftë një i vetëm apo një grumbull, që janë të barabartë me ose e tejkalojnë nivelin e materialitetit për pasqyrat financiare si tërësi; ose kur keq-deklarimi dhe/ose mos-pajtueshmëria e zbuluar brenda një klase të caktuar transaksionesh është i barabartë me ose tejkalon nivelin e materialitetit më të ulët të vendosur për këtë klasë të transaksioneve. Formulohet gjithashtu nëse ka kufizim të fushëveprimit, i cili mund të mos shpie në shmangie të keq-deklarimit(eve) material(e).

Opinion i kundërt

Formulohet kur janë zbuluar keq-deklarime dhe/ose mos-pajtueshmëri, qoftë një i vetëm apo një grumbull, që tejkalon në mënyrë të përhapur nivelin e materialitetit për pasqyrat financiare si tërësi; ose kur keq-deklarimet dhe/ose mos-pajtueshmëritë e zbuluara brenda një klase të caktuar transaksionesh e tejkalojnë në mënyrë të përhapur nivelin e materialitetit më të ulët të vendosur për këtë klasë të transaksioneve.

“E përhapur” është term që përdoret, në kontekstin e keq-deklarimeve dhe/ose mos-pajtueshmërive, për të përshkruar efektet e keq-deklarimeve dhe/ose mos-pajtueshmërisë në pasqyrat financiare; ose efektet e mundshme në pasqyrat financiare të keq-deklarimeve dhe/ose mos-pajtueshmërisë, nëse ka të tilla, që nuk zbulohen për shkak të pamundësisë për të marrë dëshmi të mjaftueshme e të duhura të auditimit. Efektet e përhapura në pasqyrat financiare janë ato që, sipas gjykimit të auditorit::

- a) Nuk kufizohen vetëm në elemente, llogari ose zëra të veçantë të pasqyrave financiare;
- b) Por nëse kufizohen si të tilla, përfaqësojnë ose mund të përfaqësojnë një pjesë të konsiderueshme të pasqyrave financiare; ose
- c) Për sa i përket shpalosjeve, janë thelbësore që përdoruesit të kuptojnë pasqyrat financiare.

Mohim i opinionit

Formulohet kur kufizimi i fushëveprimit, d.m.th. kur pamundësia për të siguruar prova të mjaftueshme të përshtatshme të auditimit, është i natyrës materiale dhe pervazive.

Paragrafët e Theksimit të Çështjes dhe paragrafët e Çështjeve të Tjera në raportin e auditorit

Nëse auditori e konsideron të nevojshme të tërheqë vëmendjen e përdoruesve në një çështje të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila është sa e rëndësishme aq edhe thelbësore që ata të kuptojnë pasqyrat financiare, por ka dëshmi të mjaftueshme e të përshtatshme se çështja nuk përmban keq-deklarime materiale në pasqyrat financiare, auditori duhet të përfshijë paragrafin e Theksimit të çështjes në raportin e tij. Paragrafi për Theksimin e Çështjes duhet t'i referohet vetëm informacionit të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare.

Paragrafi i theksimit të çështjes duhet:

- të përfshihet menjëherë pas opinionit;
- të ketë titullin 'theksim i çështjes' ose ndonjë titull tjetër të përshtatshëm;
- të përmbajë një referencë të qartë ndaj çështjes që theksohet dhe të tregojë se në ç'pjesë të pasqyrave financiare mund të gjenden shpalosjet relevante që e përshkruajnë plotësisht çështjen; dhe
- të tregojë se opinionit i auditimit nuk është modifikuar për sa i përket çështjes të theksuar.

Nëse auditori e konsideron të nevojshme të komunikojë një çështje, përveç atyre që janë paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila, në gjykimin e auditorit, është e rëndësishme për përdoruesit në mënyrë që të kuptojnë auditimin, përgjegjësitë e auditorit apo raportin e auditimit, dhe me kusht që kjo nuk është e ndaluar me ligj ose rregullore, duhet të përpilohet një paragraf me titullin "Çështje të tjera", apo ndonjë titull tjetër të përshtatshëm. Ky paragraf duhet të paraqitet menjëherë pas opinionit dhe pas çdo paragrafi të Theksimit të çështjes.

Shënimet fundore

- ¹ Pajtueshmëria me autoritetet - pajtueshmëria me të gjitha ligjet, rregullat, rregulloret, standardet dhe praktikatat e mira relevante në sektorin publik
- ² Raportet tjera janë kërkesë e nenit 8 të së Rregullores 01/2017 për Raportim Vjetor Financiar
- ³ Kolektivisht të referuara si pajtueshmëri me autoritetet
- ⁴ Çështja A dhe Rekomandimi A - nënkupton çështjet dhe rekomandimet e reja
Çështja B dhe Rekomandimi B - nënkupton çështjet dhe rekomandimet e përsëritura
Çështja C dhe Rekomandimi C- nënkupton çështjet dhe rekomandimet pjesërisht të përsëritura.
- ⁵ Buxheti Final - buxheti i aprovuar nga Kuvendi i përshtatur më pas nga Ministria e Financave
- ⁶ Pasqyrat financiare në sektorin publik përfshijnë po ashtu edhe pasqyrën(at) e ekzekutimit të buxhetit
- ⁷ Pajtueshmëria me autoritetet: pajtueshmëria me ligjet, rregulloret, standardet, apo praktikatat e mira.